AS AS

**AS-Audit Services sh.p.k**
Adresa: Rr."Kosovarëve",Nd.39, H.2, Ap.7
Njesia administrative Nr.5, 1019, Tiranë
Mobil: 069 20 99 704
E-mail: afrim.suli@outlook.com

**Raporti javor i ndërmjetëm monitorimi, periudha 11-16 Qershor 2019**

**Për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

**Monitorues/Eksperti financiar: Afrim Suli**

**Zgjedhjet: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 30 Qershor 2019**

**Partia/subjekti elektoral: Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë**

Edhe përgjatë kesaj jave kemi vazhduar punën për realizimin e shërbimit të kontraktuar, monitorimin e shpenzimeve të fushates zgjedhore të Partisë Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë(ADK). Ne vijim po ju paraqesim raportim e ndërmjetëm të vezghgimeve dhe verifikimeve të kryera e cila përfshin periudhën raportuese 11-16 Qershor 2019.

Ashtu siç kemi theksuar dhe në raportin e ndermjetem paraardhës realizimi i misionit eshtë programuar të realizohet me faza dhe faza e pare e tij janë monitorimet në terren të zyrave elektorale, aktiviteteve zgjedhore dhe kontrolli i materialeve propagandistike, evidentimi i shpenzimeve etj, nga momenti e marrjes se misionit e deri ne mbylljen e fushates 29 Qershor 2019.

Burimet e informacionit vazhdojne të mbeten verifikimet e drejperdrejta në terren pasi bashkite nuk ju pergjigjen kerkesave qe percaktojne aktet ligjore.

Ashtu si dhe në javën e parë, fokusi i monitorimit ishin ekzistenca e zyrave elektorale dhe aktiviteteve e organizuara nën siglen e partise si dhe afishimi i materialeve propagandistike. Ato synojnë kontrollin e zbatimit të ndalimeve dhe kufizimeve si, përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike të jetë në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor dhe, subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat.

Rendësi i është kushtuar sigurimit të informacionit finaciar dhe jo financiar dhe lidheshin me shpenzimet e destinuara për fushatën, dhe kryesisht në evidentimine kostove, dokumentimin e shpenzimeve me fatura blerje etj, të dhëna që do të përdoren fazat vijuese.

**Rezultatet e monitorimit dhe gjetjet e periudhes**

**a) Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara:**

Për periudhën 11-16 Qershor 2019 janë vëzhguar bashkitë si më poshtë vijon:

| Nr | Bashkitë e monitoruara ne terren | Evidenca e marrë-gjetjet, 11-16 Qershor 2019 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Ekzistenca e zyrave | Aktivitetet zgjedhore | Materiale të fushatës të ndaluara |
| | Kukës | Nuk jane gjetur zyra zgjedhore | Nuk ka patur aktivitete | Nuk ka publicitet fushate |
| | Kurbin | Nuk jane gjetur zyra zgjedhore | Nuk ka patur aktivitete | Nuk ka publicitet fushate |
| | Librazhd | Nuk jane gjetur zyra zgjedhore | Nuk ka patur aktivitete | Nuk ka publicitet fushate |
| | Prrenjas | Nuk jane gjetur zyra zgjedhore | Nuk ka patur aktivitete | Nuk ka publicitet fushate |

**a) Shkeljet e mundëshme të identifikuara të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore**

**Zyrat elektorale**

- Në bashkite e monitoruara ne terren nuk u evidentuan zyra elektoirale që përdoreshin nga ADK.

**Aktivitete zgjedhore**

- Nuk u evidentuan aktivitete të organizuara nga partia ADK.

**Materiale të fushatës të ndaluara**

- Nuk u evidentuan në asnje rast materiale me natyrë publicitare dhe propagandistike dhe kosto të mundëshme me natyrë zgjedhore.

**Emisione televizive dhe spote**

- Po ashtu dhe nga ndjekja e emisioneve radio e televizion nuk kemi konstatuar aktivitete që kanë lidhje me fushatën e këtij partie.

**Monitorues/Eksperti financiar**

**Afrim Suli**

**Tiranë, më 16 Qershor 2019**